



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 84, datë 30.04.2024

**PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT
TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“INSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe të rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/ Mbikëqyrës, administratorit/ anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e emërimit të z. Kadri Morinaj, si administrator i shoqërisë së sigurimit “Insig” sh.a.**
- 2. Afati i ushtrimit të detyrës së administratorit të shoqërisë së sigurimit “Insig” sh.a., fillon nga data e miratimit të emërimit nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, deri më datë 01.01.2026.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**